

Annex 1 to
URGENT Prosecution submissions on plea agreements and sentencing

Confidential



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE

The Specialist Prosecutor v. Sabit Januzi, Ismet Bahtijari and Haxhi Shala,**KSC-BC-2023-10****Introduction**

1. This document constitutes the Plea Agreement ('Agreement') between Haxhi SHALA, through his Specialist Counsel, Toby CADMAN, and the Specialist Prosecutor's Office ('SPO' or 'Prosecution'). This agreement sets out the entire understanding of the Parties as to its nature and consequences and as to the nature and consequences of Haxhi SHALA's admission of guilt. It is further intended to assist the Parties and the Trial Panel of the Kosovo Specialist Chambers ('KSC') in ensuring that the plea is knowingly and voluntarily made, in accordance with Rule 94 of the Rules of Procedure and Evidence before the Kosovo Specialist Chambers ('Rules').
2. The terms of the agreement are as follows:

Agreement Regarding Admission of Guilt

3. Haxhi SHALA agrees to admit guilt before the Trial Panel pursuant to Rule 94 of the Rules in relation to Counts Two (2) and Three (3) of the Indictment, dated 10 July 2024, to the extent they are alleging, in Count Two (2), obstructing official persons in performing official duties by participating in the common action of a group between at least 5 and 12 April 2023, punishable under Kosovo Criminal Code ('KCC') Articles 17, 21, 28, 33, 35, and 401(2) and (5), and Articles 15(2) and 16(3) of the Law on the Specialist Chambers and Specialist Prosecutor's Office ('Law'), and, in Count Three (3), intimidation during criminal proceedings by means of a promise of a gift or any other form of benefit, between at least 5 and 12 April 2023, punishable under KCC Articles



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE

17, 21, 31, 33, 35, and 387, and Articles 15(2) and 16(3) of the Law, including all modes of liability alleged therein.

Factual Basis

4. The principal factual basis for Haxhi SHALA's admission of guilt is set forth in the Agreed Factual Basis attached hereto as Annex 1.
5. Haxhi SHALA and the Prosecution agree that if the Prosecution were to proceed with evidence, the facts and allegations as set out in paragraphs 8-9, 11, 14-18, and 24 (sub-paragraphs i(i), ii, and iii) of the Indictment dated 10 July 2024 would be proven beyond reasonable doubt, and that those facts are true and correct and not disputed by Haxhi SHALA.
6. The Prosecution and the Specialist Counsel in consultation with Haxhi SHALA have jointly prepared the Agreed Factual Basis. Haxhi SHALA has reviewed it in a language he fully understands with his Specialist Counsel, and he affirms that the facts contained therein are true and correct to the best of his knowledge. He further agrees that those facts support a finding of guilt on the charges described at paragraph 3 above.
7. Haxhi SHALA agrees to make an admission of guilt in relation to the charges identified at paragraph 3 above because he is in fact guilty and acknowledges his guilt and accepts full responsibility for his conduct as described in the Agreed Factual Basis.

Nature of the Charges

8. Haxhi SHALA fully understands that he is admitting guilt in relation to Counts Two (2) and Three (3) of the Indictment, as described above, and specifically admitting his conduct as set forth in paragraphs 8-9, 11, 14-18, and 24 (sub-



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE

paragraphs i(i), ii, and iii) of the Indictment and as further described in the Agreed Factual Basis.

9. Haxhi SHALA understands that if a trial were held, the Prosecution would be required to prove the following elements of Articles 21, 387, and 401(2) and (5), beyond reasonable doubt:

Count Two (2)

- a. Participation in a group which by common action (KCC Article 401(2))
- b. Obstructs or attempts to obstruct an official person in performing official duties (KCC Article 401(2))
- c. The offence was committed against a judge, a prosecutor, an official of a court, prosecution officer or a person authorized by the court and prosecution office, or a police officer during the exercise of their official functions (KCC Article 401(5))
- d. Awareness of, and desire to commit, the act, or awareness that a prohibited consequence can occur as a result of the act or omission and accession to its occurrence (KCC Article 21)

Count Three (3)

- a. The use of force or serious threat, or any other means of compulsion, a promise of a gift or any other form of benefit (KCC Article 387)
- b. To induce another person to refrain from making a statement or to make a false statement or to otherwise fail to state true information to the police, a prosecutor or a judge and such information relates to obstruction of criminal proceedings (KCC Article 387)



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE

- c. Awareness of, and desire to commit, the act, or awareness that a prohibited consequence can occur as a result of the act or omission and accession to its occurrence (KCC Article 21)

Penalty and Sentencing

10. Haxhi SHALA understands that, pursuant to Article 44 of the Law, the penalties that may be imposed by a Trial Panel following a conviction in this case include:

- a. a term of imprisonment up to and including ten (10) years' imprisonment; and
- b. an order to make restitution or pay compensation to a victim or victims collectively, or to forfeit property, proceeds and any assets used for or deriving from the commission of the crime and their return to their rightful owner or sale and share between victims under Article 22 of the Law.

11. Haxhi SHALA agrees to the imposition of a sentence of three years' imprisonment.

12. Haxhi SHALA understands and agrees that:

- a. should the interpretation of the Trial Panel, as set out in decision KSC-BC-2023-10/F00612, be upheld, he will be precluded from pursuing appellate remedies against any judgment or sentencing decision which accords with the terms of this Agreement; and/or
- b. in any event, he will not appeal or otherwise challenge his sentence in the event that the Panel imposes a term of imprisonment of three (3) years or below; and



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE

- c. he will not move to withdraw his guilty plea or appeal his conviction pursuant to his guilty plea.
13. Haxhi SHALA understands that, in determining the sentence, the Trial Panel will apply the punishments for the Article 15(2) crimes provided in the 2019 KCC and, where applicable, any aggravating and mitigating factors, including the gravity of the crime and its consequences, the individual circumstances of the convicted person and any cooperation with the SPO and the KSC, as provided in Article 44 of the Law and Rule 163 of the Rules.
14. This Agreement does not in any way limit the Parties' ability to offer admissible evidence or make submissions to the Trial Panel regarding the factors referred to in paragraph 13 above or the determination of an appropriate sentence, so long as such evidence and submissions are not inconsistent with this Agreement and the Agreed Factual Basis.

Reparations

15. The SPO and Defendant Haxhi SHALA agree that, to the extent reparations may be applicable in this case, the issue of reparations will be addressed by the parties in submissions to the Trial Panel at or prior to the time of sentencing.

Agreements by the Specialist Prosecutor's Office

16. In exchange for Haxhi SHALA's admission of guilt, should it be accepted by the Trial Panel, the Prosecution agrees to the following:
- a. the Prosecution will recommend to the Trial Panel a sentence of three (3) years' imprisonment and recommend that Haxhi SHALA be given credit for the time he has served in the custody of the KSC;
- b. further:



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE

- a. should the interpretation of the Trial Panel, as set out in decision KSC-BC-2023-10/F00612, be upheld, the Prosecution will be precluded from pursuing appellate remedies against any judgment or sentencing decision which accords with the terms of this Agreement; and/or
- b. in any event, the Prosecution will not appeal or otherwise challenge the sentence imposed by the Trial Panel in the event the Panel imposes a term of imprisonment of three (3) years or above; and
- c. the SPO will withdraw without prejudice to either party the remaining charge against Haxhi SHALA as set out in the Indictment of 10 July 2024.

Consequences of the Admission of Guilt for the Exercise of Certain Rights

17. By making an admission of guilt in relation to Counts Two (2) and Three (3) of the Indictment, Haxhi SHALA understands that he will be giving up, in whole or in part, the opportunity to exercise the following rights:
- a. the right to plead not guilty and to require the Prosecution to prove the charges in the Indictment beyond reasonable doubt at a fair and impartial public trial;
 - b. the right to be tried in his presence, and to defend himself through a Specialist Counsel at such trial;
 - c. the right to raise defences and grounds for excluding criminal responsibility and to present admissible evidence at such trial (without prejudice to the right to make submissions and present evidence with regard to sentencing);



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE

- d. the right not to be compelled to testify against himself or to confess guilt;
 - e. the right to examine, or to have examined, the witnesses against him and to obtain the attendance and examination of witnesses on his behalf under the same conditions as witnesses against him (without prejudice to his right to examine any witness that may be called to testify, and his right to call witnesses and have them examined on his behalf, at any proceedings with regard to sentencing);
 - f. the right to pursue appellate remedies with regard to conviction or sentencing, as specified in paragraph 12 above.
18. It is understood that by pleading guilty, Haxhi SHALA retains all other rights, including, in particular:
- a. the right to be represented by Specialist Counsel at all stages of the proceedings and to communicate freely with such counsel in confidence; and
 - b. the right to submit any information or evidence relevant for the determination of the sentence, pursuant to Rule 162(1) and (5) of the Rules.

Voluntariness of the Admission of Guilt

19. Haxhi SHALA acknowledges that he has entered into this Agreement freely and voluntarily after sufficient consultation with his Specialist Counsel, that no threats were made to induce him to make an admission of guilt, and that the only promises made to him are those set forth in this Agreement.



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE

Agreement Not Binding on the Kosovo Specialist Chambers or on Other Jurisdictions

20. Haxhi SHALA and the Prosecution understand that no term of this Agreement is binding on the Trial Panel of the KSC, as provided in Rule 94 of the Rules.
21. The Parties further understand that the Trial Panel may propose amendments to the Agreement for consideration by the Parties, or reject Haxhi SHALA's admission of guilt and order that the trial continue under Rule 94(7) of the Rules. If the Trial Panel orders the trial to continue under Rule 94(7) of the Rules, it will consider the admission of guilt as not having been made.
22. Haxhi SHALA understands that the Agreement does not bind the KSC, nor any other national or international authorities or organisations.

Other Agreements

23. Except as expressly set forth herein, there are no promises, understandings, or agreements between the Prosecution and Haxhi SHALA or his Specialist Counsel, Toby CADMAN.


Declaration of Haxhi SHALA

24. I, Haxhi SHALA, have read this Agreement in a language which I fully understand, and have carefully reviewed every part of it with my Specialist Counsel, Toby CADMAN. Toby CADMAN has advised me of the nature of the charges against me, my rights, possible defences, and of the consequences of entering into this Agreement and making an admission of guilt. No other promises or inducements have been made to me, other than those contained in this Agreement. Furthermore, no one has threatened or forced me in any way to enter into this Agreement. I have entered into this Agreement freely and



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE

voluntarily, and I am of sound mind. I understand the terms of this Agreement, and I voluntarily agree to each of them.



Haxhi SHALA

04.12.2024

Date

Declaration of Toby CADMAN

25. I, Toby CADMAN, in the capacity of Haxhi SHALA's Specialist Counsel, have carefully reviewed every part of this Agreement with my client. Furthermore, I have fully advised my client of his rights, and possible defences, of the maximum possible sentence, and of the consequences of entering into this Agreement and of making an admission of guilt. To my knowledge, my client is of sound mind and his decision to enter into this Agreement is an informed and voluntary one.



Toby CADMAN


Specialist Counsel for Haxhi SHALA

03/12/2024

Date

26. The undersigned parties fully agree to each and every term and condition of this Agreement:

Done in English and Albanian, the English being authoritative.



Haxhi SHALA

4.12.2024

Date



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE

T. Cadman

03/12/2024

Toby CADMAN

Date

Specialist Counsel for Haxhi SHALA

Tazneen Shahabuddin

4/12/24

Tazneen SHAHABUDDIN

Date

Prosecutor

Kimberly P. West

4 December 2024

Kimberly P. WEST

Date

Specialist Prosecutor



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE

ANNEX 1AGREED FACTUAL BASIS

The Defendant Haxhi SHALA accepts that he was part of a group which sought to induce Witness 1 to refrain from giving evidence before the Kosovo Specialist Chambers through the promise of a benefit. In particular, members of the group – acting at the direction of the Defendant Haxhi SHALA – approached Witness 1 at his home on 5 and 12 April 2023, respectively. During the 5 April 2023 approach, Ismet BAHTIJARI told Witness 1 that he should withdraw his testimony before the Kosovo Specialist Chambers. During the 12 April 2023 approach, Sabit JANUZI followed up on the first approach and relayed to Witness 1 an offer that the Defendant Haxhi SHALA and others would help him if he withdrew his testimony. Before and after each of the 5 and 12 April 2023 approaches the Defendant Haxhi SHALA communicated and coordinated with other group members regarding their interactions with Witness 1.



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE

Prokurori i Specializuar kundër Sabit JANUZIT, Ismet BAHTIJARIT dhe Haxhi SHALËS,**KSC-BC-2023-10**Hyrje

1. Ky dokument përbën Marrëveshjen e Pranimit të Fajësisë ("Marrëveshja") ndërmjet Haxhi SHALËS, nëpërmjet Mbrojtësit të tij të Specializuar, Toby CADMAN, dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar ("ZPS" ose "Prokuroria"). Kjo marrëveshje përcakton të gjithë mirëkuptimin e Palëve për natyrën dhe pasojat e saj, dhe për natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit nga Haxhi SHALA. Më tej, ajo ka për synim t'i ndihmojë palët dhe Trupin Gjykses të Dhomave të Specializuara të Kosovës ('DHSK') për të siguruar që pranimi i fajësisë të jetë bërë me vetëdije dhe vullnetarisht, në përputhje me Rregullën 94 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave pranë Dhomave të Specializuara të Kosovës ('Rregullore').
2. Kushtet e marrëveshjes janë si më poshtë:

Marrëveshja në lidhje me Pranimin e Fajit

3. Haxhi SHALA bie dakord të pranojë fajin para Trupit Gjykses në përputhje me Rregullën 94 të Rregullores në lidhje me Pikat Dy (2) dhe Tre (3) të Aktakuzës, të datës 10 korrik 2024, në masën që ata pretendojnë, në Pikën Dy (2), pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare duke marrë pjesë në aksionin e përbashkët të një grupi midis më së paku 5 prillit dhe 12 prillit 2023, e dënueshme sipas Kodit Penal të Kosovës ('KPK') nenet 17, 21, 28, 33, 35, dhe 401(2) dhe (5), dhe nenet 15(2) dhe 16(3) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ('Ligji'), dhe, në Pikën Tre (3), frikësim gjatë procedurave penale me anë të premtimit për dhuratë ose çfarëdo forme



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE

tjetër përfitimi, midis më së paku 5 prillit dhe 12 prillit 2023, e dënueshme sipas neneve 17, 21, 31, 33, 35 dhe 387 të KPK-së dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit, duke përfshirë të gjitha mënyrat e përgjegjesisë të pretenduara në të.

Baza faktike

4. Baza kryesore faktike për pranimin e fajit nga Haxhi SHALA është paraqitur në Bazën Faktike të Rënë Dakord bashkëngjitur këtu si Shtojca 1.
5. Haxhi SHALA dhe Prokuroria pajtohen që nëse Prokuroria do të bënte paraqitjen e provave, atëherë faktet dhe akuzat e përcaktuara në paragrafët 8-9, 11, 14-18 dhe 24 (nën-paragrafët i(i), ii, dhe iii) të Aktakuzës së datës 10 korrik 2024 do të vërtetoheshin jashtë dyshimit të arsyeshëm, dhe se ato fakte janë të vërteta dhe të sakta dhe nuk kundërshtohen nga Haxhi SHALA.
6. Prokuroria dhe Mbrojtësi i Specializuar në konsultim me Haxhi SHALËN kanë përgatitur bashkërisht Bazën Faktike të Rënë Dakord. Haxhi SHALA e ka shqyrtuar atë në një gjuhë që ai e kupton plotësisht me Mbrojtësin e tij të Specializuar dhe ai pohon se faktet e përfshira në të janë të vërteta dhe të sakta me aq sa di ai. Ai më tej pajtohet se këto fakte mbështesin konstatimin e fajit për akuzat e përshkruara në paragrafin 3 më lart.
7. Haxhi SHALA bie dakord të pranojë fajësinë në lidhje me akuzat e identifikuara në paragrafin 3 më lart, sepse ai në fakt është fajtor dhe e pranon fajin e tij, dhe pranon përgjegjësinë e plotë për sjelljen e tij, siç përshkruhet në Bazën Faktike të Rënë Dakord.

Natyra e akuzave



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE

8. Haxhi SHALA e kupton plotësisht se ai po e pranon fajësinë në lidhje me Pikat Dy (2) dhe Tre (3) të Aktakuzës, siç përshkruhet më lart, dhe konkretisht pranon sjelljen e tij të përcaktuar në paragrafët 8-9, 11, 14-18, dhe 24 (nën-paragrafët i(i), ii, dhe iii) të Aktakuzës dhe siç përshkruhet më tej në Bazat Faktike të Rëna Dakord.
9. Haxhi SHALA e kupton se nëse do të zhvillohej një gjykim, Prokurorisë do t'i kërkohej të provonte elementet e mëposhtme të neneve 21, 387 dhe 401(2) dhe (5), jashtë dyshimit të arsyeshëm:

Pika Dy (2)

- a. Pjesëmarrja në një grup personash i cili, përmes veprimit të përbashkët (neni 401(2) i Kodit Penal të Kosovës)
- b. Pengon ose tenton të pengojë një person zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare (neni 401(2) i KPK-së)
- c. Vepra penale është kryer ndaj një gjyqtari, prokurori, zyrtari të gjykatës, zyrtari të prokurorisë ose ndaj një personi të autorizuar nga gjykata dhe prokuroria, ose ndaj një oficeri policie në kryerjen e detyrave të tyre zyrtare (neni 401(5) i KPK-së)
- d. Vetëdija dhe dëshira për të kryer aktin, ose vetëdija se një pasojë e ndaluar mund të ndodhë si rezultat i veprimit ose mosveprimit dhe bashkimit në ndodhjen e tij (neni 21 i KPK-së).

Pika Tre (3)

- a. Përdorimi i forcës ose kërcënimit të rëndë, ose ndonjë mënyre tjetër të detyrimit, premtimi për dhuratë ose ndonjë formë tjetër përfitimi (neni 387 i KPK-së)



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE

- b. Nxitja e një personi tjetër që të mos jepte deklaratë ose të jepte deklaratë të rreme, ose të mos i jepte informacion të vërtetë policisë, prokurorit ose gjykatësit dhe ky informacion ka të bëjë me pengimin e procedurës penale (neni 387 i KPK-së).
- c. Vetëdija dhe dëshira për të kryer aktin, ose vetëdija se një pasojë e ndaluar mund të ndodhë si rezultat i veprimit ose mosveprimit dhe bashkimit në ndodhjen e tij (neni 21 i KPK-së).

Ndëshkimi dhe Dënimi

10. Haxhi SHALA e kupton se, në bazë të nenit 44 të Ligjit, ndëshkimet që mund të shqiptohen nga trupi gjykues pas dhënies së dënimit në këtë çështje përfshijnë:

- a. dënim me burgim deri në dhjetë (10) vjet; dhe
- b. një urdhër për t'i dhënë dëmshpërblim ose paguar kompensim një viktime apo viktimave bashkërisht, ose për të konfiskuar pronën, të ardhurat dhe asetet që përdoren për kryerjen e krimit dhe që rrjedhin nga kryerja e krimit, dhe kthimin e tyre tek pronari i ligjshëm, ose shitjen dhe ndarjen mes viktimave sipas nenit 22 të Ligjit.

11. Haxhi SHALA pajtohet me shqiptimin e dënimit me tre vjet burgim.

12. Haxhi SHALA e kupton dhe pajtohet se:

- a. në qoftë se interpretimi i Trupit Gjykues, siç është përcaktuar në vendimin KSC-BC-2023-10/F00612, lihet në fuqi, kjo e pengon atë që të ndjekë mjete juridike të apelit kundër çdo aktgjykimi apo vendimi dënimi që përputhet me kushtet e kësaj Marrëveshjeje; dhe/ose



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE

- b. në çdo rast, ai nuk do të apelojë ose nuk do ta kundërshtojë dënimin e tij në rast se Paneli shqipton një dënim prej tre (3) vjetësh ose më pak; dhe
- c. ai nuk do të veprojë për të tërhequr pranimin e fajësisë ose për të apeluar dënimin e tij në përputhje me pranimin e tij të fajësisë.

13. Haxhi SHALA e kupton se, në përcaktimin e dënimit, Trupi Gjykses do të zbatojë ndëshkimet për krimet e nenit 15(2) të parashikuara në Kodin Penal të Kosovës të vitit 2019 dhe, aty ku është e aplikueshme, çdo faktor rëndues dhe lehtësues, duke përfshirë peshën e krimit dhe pasojat e tij, rrethanat individuale të personit të dënuar dhe çdo bashkëpunim me ZPS-në dhe DHSK-në, siç parashikohet në nenin 44 të Ligjit dhe rregullën 163 të Rregullores.
14. Kjo Marrëveshje nuk kufizon në asnjë mënyrë aftësinë e Palëve për të ofruar prova të pranueshme ose për t'i bërë parashtrime Trupit Gjykses në lidhje me faktorët e përmendur në paragrafin 13 më lart ose përcaktimin e një dënimi të përshtatshëm, për sa kohë që këto prova dhe parashtrime nuk janë në kundërshtim me këtë Marrëveshje dhe me Bazën Faktike të Rënë Dakord.

Dëmshpërblimet

15. ZPS-ja dhe i Pandehuri Haxhi SHALA pajtohen që, për aq sa mund të zbatohen dëmshpërblimet në këtë rast, çështja e dëmshpërblimeve do të adresohet nga palët në parashtrimet e tyre pranë Trupit Gjykses në kohën ose para kohës së shqiptimit të dënimit.

Marrëveshjet nga Zyra e Prokurorit të Specializuar

16. Në këmbim të pranimit të fajit nga Haxhi SHALA, nëse pranohet nga Trupi Gjykses, Prokuroria bie dakord me sa vijon:



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE

- a. Prokuroria do t'i rekomandojë Trupit Gjykses dënimin me tre (3) vjet burgim dhe do të rekomandojë që Haxhi SHALËS t'i llogaritet koha që është mbajtur në paraburgim në Dhomat e Specializuara të Kosovës;
- b. më tej:
 - a. nëse interpretimi i Trupit Gjykses, siç është përcaktuar në vendimin KSC-BC-2023-10/F00612, lihet në fuqi, kjo e pengon Prokurorinë që të ndjekë mjete juridike të apelit kundër çdo aktgjykimi apo vendimi dënimi që përputhet me kushtet e kësaj Marrëveshjeje; dhe/ose
 - b. në çdo rast, Prokuroria nuk do të apelojë ose nuk do ta kundërshtojë dënimin e shqiptuar nga Trupi Gjykses në rast se trupi gjykses shqipton një dënim prej tre (3) vjetësh ose më shumë; dhe
- c. ZPS-ja do të tërheqë, pa paragjykuar veprimet e ardhshme të asnjërës palë, akuzën e mbetur kundër Haxhi SHALËS siç është përcaktuar në Aktakuzën e datës 10 korrik 2024.

Pasoja të Pranimi të Fajit për ushtrimin e disa të drejtave të caktuara

17. Duke pranuar fajësinë në lidhje me Pikat Dy (2) dhe Tre (3) të Aktakuzës, Haxhi SHALA kupton se do të heqë dorë, tërësisht ose pjesërisht, nga mundësia për të ushtruar të drejtat e mëposhtme:
- a. e drejta për t'u deklaruar i pafajshëm dhe për të kërkuar nga Prokuroria që të provojë akuzat në Aktakuzë jashtë dyshimit të arsyeshëm në një gjykim publik të drejtë dhe të paanshëm;
 - b. e drejta për t'u gjykuar në prani të tij dhe për t'u mbrojtur nga një Mbrojtës i Specializuar në një gjykim të tillë;



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE

- c. e drejta për të ngritur mbrojtje dhe arsye për përjashtimin e përgjegjësisë penale dhe për të paraqitur prova të pranueshme në një gjykim të tillë (pa paragjykuar ushtrimin e të drejtës për të bërë parashtrime dhe për të paraqitur prova në lidhje me dënimin);
- d. e drejta që të mos detyrohet të dëshmojë kundër vetes ose të pranojë fajin;
- e. e drejta për të marrë në pyetje, ose të merren në pyetje, dëshmitarët kundër tij dhe për të siguruar pjesëmarrjen dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në emër të tij në të njëjtat kushte si dëshmitarët kundër tij (pa paragjykuar ushtrimin e të drejtës së tij për të marrë në pyetje çdo dëshmitar që mund të thirret për të dëshmuar, dhe të drejtën e tij për të thirrur dëshmitarë dhe për t'i marrë ata në pyetje në emër të tij, në çdo procedurë lidhur me dënimin);
- f. e drejta për të ndjekur mjete juridike të apelit lidhur me vendimin e fajësisë, apo përcaktimin e dënimit, siç është specifikuar në paragrafin 12 më lart.

18. Kuptohet se duke u deklaruar fajtor, Haxhi SHALA ruan të gjitha të drejtat e tjera, duke përfshirë, në veçanti:

- a. të drejtën për t'u përfaqësuar nga një Mbrojtës i Specializuar në të gjitha fazat e kryerjes së procedurës dhe për të komunikuar lirshëm me një mbrojtës të tillë në mirëbesim; dhe
- b. të drejtën për të paraqitur çdo informacion ose provë relevante për përcaktimin e dënimit, në përputhje me Rregullën 162 (1) dhe (5) të Rregullores.



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE

Pranimi në mënyrë vullnetare i fajit

19. Haxhi SHALA pranon se ai ka bërë këtë Marrëveshje lirisht dhe vullnetarisht pas konsultimeve të mjaftueshme me Mbrojtësin e tij të Specializuar, se nuk janë bërë kërcënime për ta shtyrë atë të pranojë fajin dhe se të vetmet premtime që i janë bërë janë ato të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

Marrëveshje jodetyruese për Dhomat e Specializuara të Kosovës apo për Juridiksione të tjera

20. Haxhi SHALA dhe Prokuroria e kuptojnë se asnjë kusht i kësaj Marrëveshjeje nuk është i detyrueshëm për Trupin Gjykes të DHSK-së, siç parashikohet në Rregullën 94 të Rregullores.

21. Palët kuptojnë më tej se Trupi Gjykes mund të propozojë ndryshime në Marrëveshje për t'u shqyrtuar nga Palët, ose të refuzojë pranimin e fajit të Haxhi SHALËS dhe të urdhërojë që gjykimi të vazhdojë sipas Rregullës 94(7) të Rregullores. Nëse Trupi Gjykes urdhëron që gjykimi të vazhdojë sipas Rregullës 94(7) të Rregullores, ai do të konsiderojë që pranimi i fajit nuk është bërë.

22. Haxhi SHALA e kupton që Marrëveshja nuk është detyruese për DHSK-në, as ndonjë autoritet apo organizatë tjetër kombëtare apo ndërkombëtare.

Marrëveshje të tjera

23. Me përjashtim të rasteve të përcaktuara shprehimisht këtu, nuk ka premtime, mirëkuptime ose marrëveshje midis Prokurorisë dhe Haxhi SHALËS ose Mbrojtësit të tij të Specializuar, Toby CADMAN.

Deklarata e Haxhi SHALËS

24. Unë, Haxhi SHALA, e kam lexuar këtë Marrëveshje në një gjuhë që e kuptoj plotësisht dhe kam shqyrtuar me kujdes çdo pjesë të saj me Mbrojtësin tim të



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE

Specializuar, Toby CADMAN. Toby CADMAN më ka këshilluar për natyrën e akuzave kundër meje, për të drejtat e mia, për mbrojtjen e mundshme dhe për pasojat e lidhjes së kësaj Marrëveshjeje dhe pranimit të fajit. Mua nuk më është bërë asnjë premtim apo nxitje tjetër, përveç atyre që përmbahen në këtë Marrëveshje. Për më tepër, mua nuk më ka kërcënuar apo detyruar askush, në asnjë mënyrë, për të bërë këtë Marrëveshje. Unë e kam bërë këtë Marrëveshje lirisht dhe vullnetarisht dhe gëzoj shëndet të plotë mendor. Unë i kuptoj kushtet e kësaj Marrëveshjeje dhe pajtohem vullnetarisht me secilën prej tyre.

Haxhi SHALA

Data

Deklarata e Toby CADMAN

25. Unë, Toby CADMAN, në cilësinë e Mbrojtësit të Specializuar të Haxhi SHALËS, kam shqyrtuar me kujdes çdo pjesë të kësaj Marrëveshjeje me klientin tim. Për më tepër, unë e kam këshilluar plotësisht klientin tim për të drejtat e tij dhe mbrojtjen e mundshme, për dënimin maksimal të mundshëm dhe për pasojat e lidhjes së kësaj Marrëveshjeje dhe të pranimit të fajit. Në dijeninë time, klienti im gëzon shëndet të plotë mendor dhe vendimi i tij për të bërë këtë Marrëveshje është një vendim i marrë me dijeninë e tij dhe në mënyrë vullnetare.

03/12/2024

Toby CADMAN

Data

Mbrojtës i Specializuar për Haxhi SHALËN



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE

26. Palët e nënshkruara pajtohen plotësisht me çdo term dhe kusht të kësaj

Marrëveshjeje:

E bërë në gjuhën angleze dhe shqipe dhe anglishtja është versioni autentik.



Haxhi SHALA

09.12.2024

Data



Toby CADMAN

03/12/2024

Data

Mbrojtës i Specializuar për Haxhi SHALËN




Tazneen SHAHABUDDIN

4/12/24

Data

Prokurore



Kimberly P. WEST

4 December 2024

Data

Prokurorja e Specializuar



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE

SHTOJCA 1BAZA FAKTIKE E RËNË DAKORD

I pandehuri Haxhi SHALA pranon se ai ishte pjesë e një grupi që kërkonte të nxiste Dëshmitarin 1 që të mos jepte dëshmi para Dhomave të Specializuara të Kosovës përmes premtimit për përfitim. Në veçanti, anëtarët e grupit – duke vepruar nën drejtimin e të pandehurit Haxhi SHALA – i shkuan Dëshmitarit 1 në shtëpinë e tij, përkatësisht më 5 dhe 12 prill 2023. Gjatë vizitës së 5 prillit 2023, Ismet BAHTIJARI i tha Dëshmitarit 1 se ai duhet të tërhiqte dëshminë e tij para Dhomave të Specializuara të Kosovës. Gjatë vizitës së 12 prillit 2023, Sabit JANUZI në vijim të vizitës së parë, i transmetoi Dëshmitarit 1 një ofertë që i pandehuri Haxhi SHALA dhe të tjerët do ta ndihmonin atë nëse ai e tërhiqte dëshminë e tij. Para dhe pas çdo vizite më 5 dhe 12 prill 2023, i pandehuri Haxhi SHALA komunikoi dhe koordinoi me anëtarët e tjerë të grupit për ndërveprimet e tyre me Dëshmitarin 1.